

DHOMA E POSAÇME
E GJYKATËS
SUPREME TË
KOSOVËS PËR
ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME
AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF
THE SUPREME COURT
OF KOSOVO ON
KOSOVO TRUST
AGENCY RELATED
MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA KOJA
SE ODOSE NA
KOSOVSKU POVERENIČKU
AGENCIJU

SCEL – 09 – 0007

2. [REDACTED]

Ankuesit

kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit
NSH "[REDACTED]", Prizren

I Padituri

Trupi Gjykues i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme/DHPGJS/Dhoma), i përbërë nga Antoinette Lepeltier - Durel, Gjyqtare Kryesuese, Esma Erterzi, dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 16 dhjetor 2010, lëshon këtë

AKTGJYKIM

1. **Miratohen** ankesat e [REDACTED] për përfshirjen e tyre në listën e punëtorëve me të drejtë legjitime për përfitimin e një pjese nga të ardhurat prej privatizimit të NSH-së "[REDACTED]", me seli në Prizren. Agjencia Kosovare e Privatizimit **urdhërohet** që t'i përfshijë emrat e Ankuesve të mësipërm në listën e publikuar të punëtorëve të kualifikuar për ta gëzuar pjesën e 20%-shit nga të ardhurat prej privatizimit të Ndërmarrjes Shoqërore "[REDACTED]", me seli në Prizren.
2. Periudha kohore për dërgim pranë NSH-së do të merret parasysh nga Agjencia në kuptim të Nenit 10.5 lit (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13:
 - a. për ankuesin [REDACTED] është prej 22 nëntorit 1963 deri më 9 qershor 1999.
 - b. për ankuesin [REDACTED] është prej 15 qershorit 1976 deri më 26

qershor 1992.

3. I padituri është i obliguar që t'ia paguajë avokates [REDACTED], përfaqësuese e Ankuesit [REDACTED], sipas nr. 1 shpenzimet e paraqitjes në seancën gjyqësore në shumën prej 101 eurove.

4. I padituri është i obliguar që t'ia paguajë avokatit [REDACTED], përfaqësuesi i Ankuesit [REDACTED], sipas nr. 2 shpenzimet e paraqitjes në seancën gjyqësore në shumën prej 101 eurove.

Formatted: Highlight

I. Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Lista zyrtare e punëtorëve të kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) "[REDACTED]" nga Prizreni të kualifikuar për përfitimin e një pjese nga të ardhurat prej privatizimit të NSH-së në fjalë të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ishte publikuar më 7, 8, 9, 10, 11 maj 2009, përkatësisht në gazetën kryesore në gjuhën shqipe me titull të gjerë në Kosovë si dhe në gazetën kryesore në gjuhën serbe me një njoftim se ankesat kundër listës duhet të dërgohen në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas publikimit të fundit në media në pajtim me nën-paragrafin 10.3 të Rregullores (RREG) së UNMIK-ut 2003/13.

Më 26 maj 2009, [REDACTED], ankuesi i parë, ushtroi pranë Dhomës së Posaçme një ankesë kundër listës përfundimtare të punëtorëve legjitim të NSH-së "[REDACTED]" e përpiluar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), e cila *de facto* vepron si administratore e NSH-së. Më pas, [REDACTED], ankuesi i dytë, e parashtrroi një ankesë lidhur me listën e njëjtë. E fundit ishte regjistruar më 1 qershor 2009.

Në pajtim me Nenin 67.7 të Urdhërësës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6, një kopje e secilës ankesë i është dorëzuar AKP-së nga Dhoma e Posaçme. AKP-ja *si e paditur* i paraqiti vërejtjet e saj me shkrim në mënyrë të ndarë për secilën ankesë duke pohuar se asnjëri nga ankuesit nuk ishte regjistruar si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit dhe prandaj ankesat do të refuzohen si të pabaza.

Më 9 qershor 2009, Dhoma urdhëroi dërgimin e përgjigjeve të AKP-së tek ankuesit për reagimet e tyre. Ankuesi [REDACTED] e konfirmoi pranimin e përgjigjes së AKP-së më 22 qershor 2009; megjithatë, ai nuk e ka paraqitur asnjë reagim. Sa i përket dërgimit të përgjigjes tek ankuesi [REDACTED], Gjykata është përballur me pengesa për ta marrë konfirmimin e pranimit të përgjigjes, në këtë mënyrë ta caktojë edhe seancën dëgjimore. Më në fund, ankuesi e dërgoi një vërejtje me shkrim nëpërmjet faksit që ishte dërguar tek ai nga Gjykata në mënyrë që të tregojë se ai e ka pranuar atë.

Më 28 korrik 2009, Gjyqtari i ngarkuar e urdhëroi AKP-në të dorëzojë:

1. Detajet për Komisionin Shqyrtues të Agjencisë që merret me listën e punëtorëve

të me të drejta legjitime, duke përfshirë përbërjen, emrin dhe pozitat, të vërtetuara me dëshmi dokumentuese p.sh. procesverbali i nënshkruar i Komisionit,

2. Kopjen e dosjes për shqyrtimin e përcaktimit të statusit të NSH-së "██████████".

AKP-ja e bashkëngjiti një kopje të raportit të quajtur "vërejtje me shkrim" të muajit korrik 2009, i nënshkruar nga paneli shqyrtues dhe një kopje të dosjes për shqyrtimin e përcaktimit të statusit të NSH-së "██████████" me përgjigjen e saj të dërguar më 31 korrik 2009. Në "vërejtjet me shkrim" të cekura u paraqitën informata të përgjithshme së bashku me përgjigjet për katër ankesat të parashtruara nga ██████████ tek Komisioni Shqyrtues i AKP-së duke përsëritur se asnjëri nga ata nuk ishte i kualifikuar për të ardhurat nga 20%-shi. Në fund të "vërejtjeve me shkrim" janë përmendur emrat e Panelit Shqyrtues të AKP-së i përbërë prej pesë anëtarëve së bashku me nënshkrimet e tyre.

Sipas "vërejtjeve me shkrim"; NSH-ja ishte shitur nëpërmes spin off-it të rregullt të programit të privatizimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM); asetet dhe detyrimet e saj janë transferuar tek Ndërmarrja e Re SH.P.K.; kontrata për shitjen në mes të AKP-së dhe ofertuesit fitues u ratifikua më 18 dhjetor 2006; dhe çmimi i blerjes ishte 616,000.00 euro.

Në këtë raport është theksuar se lista e përkohshme e punëtorëve ishte publikuar më 3 dhe 5 maj 2007 dhe data përmbyllëse për parashkrimin e ankesave tek Agjencia ishte 28 maj 2007 siç përcaktohet në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2006/17, Neni 64.2, pa ofruar ndonjë dëshmi të asaj liste të përkohshme të punëtorëve të kualifikuar e cila ishte publikuar në media në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2006/17.

Më 11 shtator 2009, Gjyqtari i ngarkuar e lëshoi edhe një urdhër tjetër tek i Padituri duke kërkuar dërgimin e

- librin amë të NSH-së;
- listën e plotë të punëtorëve në kohën e privatizimit;
- dëshminë se lista e punëtorëve të kualifikuar ishte publikuar në media në pajtim Nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, dhe
- kopjen e plotë të dosjes të NSH-së "██████████" të regjistruar pranë AKP-së lidhur me punëtorët e ██████████

AKP-ja ia dorëzoi Dhomës së Posaçme dokumentet e nevojshme përveç librit amë për të cilin është pohuar se nuk ishte dorëzuar tek Agjencia nga menaxhmenti i NSH-së.

II. Arsyetimi Ligjor

A. Ligji Përkatës

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë bëhet nga Agjencia Kosovare e

Mirëbesimit dhe/ose Agjencia Kosovare e Privatizimit *de facto* varësisht se kur ka filluar procesi i privatizimit. Që të dyja janë agjenci të themeluara prej ligjvënësve të ndryshëm për t'i administruar NSH-të në Kosovë; e para ishte themeluar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, e ndryshuar), ndërsa e fundit ishte bërë nga Kuvendi i Kosovës pas shpalljes së pavarësisë (me Ligjin Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067).

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 e rregullon transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore. Neni 10 i Rregullores në fjalë është i përkushtuar për kualifikimin e punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore.

Nenet 10.2 dhe 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e përcaktojnë procedurën për tu zbatuar nga Agjencia për sa i përket përpilimit të listës së punëtorëve të kualifikuar. Fillimisht, organi përfaqësues i punëtorëve të ndërmarrjes, në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, e harton në bazë jodiskriminuese listën e punëtorëve me të drejta legjitime dhe më pas ia dërgon atë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Agjencia e shqyrton listën dhe i bën ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë punëtorët me të drejta legjitime në fondet që duhen shpërndarë. Më pas, në pajtim me Nenin 67.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, publikohet lista e përkohshme, bashkë me një njoftim për publikum mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrijë ankesë në këtë Agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët e gëzojnë të drejtën. Përfundimisht, në pajtim me Nenin 67.5 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, pasi që i ka adresuar siç duhet të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet, i Padituri do ta rregullon listën e punëtorëve me drejtë legjitime, nëse është e nevojshme, në përputhje me rrethanat, dhe me aktvendimin e Bordit të Drejtorëve të tij në pajtim me Nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, që duhet të përmbajë një justifikim të arsyetuar për përfshirjen apo mospërfshirjen të secilit person në listën e pranimit ose refuzimit e kundërshtimeve të tjera në listë, zyrtarisht ta përpilojë listën e punëtorëve me të drejta legjitime. Lista e punëtorëve me të drejta legjitime e përpiluar si e tillë duhet të publikohet në pajtim me Nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Nenet 10.4 dhe 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 i përcaktojnë kërkesat të cilat duhen plotësuar nga një punëtor për t'u konsideruar me të drejta legjitime për listë. Neni 10.4 shprehimisht thekson se punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Mospërmbushja e një kërkesë të tillë nuk do ta pengojë përfshirjen në listë të punëtorit i cili pretendon se ai do të ishte i kualifikuar për listën, në qoftë se ai nuk do të ishte objekt i diskriminimit.

Lidhur me diskriminimin, Kuvendi i Kosovës, në pajtim me Rregulloren Nr. 2001/9, të datës 15 maj 2001, për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, posaçërisht në dispozitat e Krerëve 3.1, 3.2 dhe 5.7 dhe më tutje, më 30.07.2004, e miratoi Ligjin Kundër Diskriminimit Nr. 2004/3 që gjithashtu ishte shpallur nga PSSP-ja i bashkëngjitur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32 lëshuar mbi shpalljen e Ligjit Kundër Diskriminimit miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Neni 8 mbi "Barra e provave" e Ligjit në fjalë thekson si në vijim:

"8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të lërtthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmive statistikore."

Neni 11 i të njëjtit Ligj thotë:

"11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kejo fushë.

11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë rlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji".

Në mënyrë që të vërtetohet fakti nëse Ligji Kundër Diskriminimit e zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13, Neni 10.6 (b) kur ka të bëjë me argumentet e dëshmive të kërkuara për vërtetimin e diskriminimit, Dhoma më 28.10.2005 i kërkoi Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) që ta paraqesë një sqarim lidhur me këtë çështje. Më 11 janar 2006, PSSP-ja u përgjigj pozitivisht. Veçanërisht, ai shtoi: "Në pajtim me Nenin 11 të Ligjit Kundër Diskriminimit, Neni 8 i këtij Ligji i cili ishte miratuar më pas, e zëvendëson Nenin 10.6 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13."

Kur ankuesi nuk është i përfshirë në listën e punëtorëve si rezultat i diskriminimit, Neni 8.1 i Ligjit Kundër Diskriminimit thekson qartë se faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të lërtthortë duhet të paraqiten nga ankuesit. Ligji e përcakton qartë obligimin e të paditurit për ta rishikuar listën dhe të bëjë rregullime të tilla të nevojshme për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë punëtorët.

B. Vlerësimi i listës së publikuar dhe pranueshmëria e ankesave si të afatshme

Është obligim i të paditurit që ta përpilojë një listë të punëtorëve me të drejta legjitime pranë NSH-së që janë të kualifikuar për përfitimin e një pjese nga të ardhurat prej privatizimit të ndërmarrjes dhe ta publikojë atë në gazetën kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë si dhe në gazetën kryesore në gjuhën serbe në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në pajtim me Nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Pas paraqitjes së kërkesës nga individë apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5 të rregullores së njëjtë, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13. Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime.

Në këtë lëndë, Trupi Gjykses e sheh se publikimi i fundit ishte bërë më 11 maj 2009. Prandaj, duke pasur parasysh Nenin 20.1 lit (a) të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, periudha për ta parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër listës ka kaluar më 31 maj 2009. Trupi Gjykses e sheh se ajo periudhë ka kaluar të dielën, prandaj ajo zgjatet deri në fund të ditës së parë të ardhshme të punës që i bie të jetë më 1 qershor 2009.

Ankesa e parë ishte paraqitur në Dhomën e Posaçme më 26 maj 2009 dhe e dyta ishte më 1 qershor 2009. Prandaj, që të dy ankesat do të merren parasysh si të afatshme.

C. Meritat

1. Sa i përket Ankuesit [REDAKTUAR]

(a) Parashtrësit e palëve

Ankuesi [REDAKTUAR] parashtrë një ankesë në Dhomën e Posaçme me anë të cilës ka theksuar se ai ka punuar për NSH [REDAKTUAR] Prizren nga 22 nëntori 1963 e deri më 9 qershor 1999. Ai theksoi se ka qenë objekt i diskriminimit kur ai ishte larguar nga Prizreni. Si dëshmi, ai e bashkëngjiti në padë një kopje të librezës së punët të tij. Sipas librezës së punës; ai ka punuar për NSH [REDAKTUAR] Prizren nga 22 nëntori 1963 e deri më 9 qershor 1999. Trupi Gjykses e sheh se librezja e punës ishte mbyllur në atë datë në këtë NSH. Më pastaj, ai ka punuar në një tjetër NSH dhe se ai ka pasur disa angazhime private më vonë. Ai gjithashtu e ka paraqitur një dokument nga Fondi i Sigurimit të Serbisë.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi ishte përfaqësuar nga Jelena Nikolic në pajtim me autorizimin e ofruar nga Gjykata. Përfaqësuesja e ankuesit ka konfirmuar se ankuesi nuk ka punuar gjatë kohës së privatizimit pasi që ai ishte Person i Zhvendosur Brenda. Përfaqësuesi i ankuesit ka pohuar se, gjatë kohës së privatizimit, ankuesi ishte në Serbinë qendrore por se diskualifikimi i tij ishte si rezultat i diskriminimit të cilin ai e ka përjetuar. Për këtë qëllim, ajo e ka paraqitur kopjen e dokumentit të identifikimit të ankuesit duke e paraqitur atë si person të zhvendosur brenda (IDP).

I padituri AKP-ja, në përgjigjen e saj ndaj padisë, ka pohuar se librezja e punës së ankuesit ishte mbyllur më 9 qershor 1999 dhe më pas ishte rihapur në ndërmarrjet e tjera. AKP-ja më tej ka pohuar se edhe pse ankuesi ka pretenduar për diskriminim, ai nuk e ka

mbështetur ankesën e tij me dëshmi materiale siç kërkohet nga Rregullorja e UNMIK-ut.

Gjatë seancës dëgjimore, Përfaqësuesi i AKP-së pohoi se sipas librezës së punës origjinale ankuesi ka punuar për NSH-në deri në vitin 1999. Pastaj ai e krijoi një punë të re dhe punoi atje deri në vitin 2008. Prandaj, ai nuk ka qenë në listën e punëtorëve në kohën e privatizimit dhe ai nuk ka bërë kërkesë në Komisionin Shqyrtues të AKM-së. AKP-ja i përsëriti argumentet e saj lidhur me atë se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për diskriminimin e pretenduar.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

Ankuesi pretendoi diskriminim dhe gjithashtu paraqiti dëshmi se ishte person i zhvendosur brenda, fakt të cilin nuk e ka lejuar atë as që të qëndrojë në Kosovë dhe as të punojë me NSH-në pas luftës. Trupi Gjykses e sheh se marrëdhënia e tij e punës me NSH-në ishte përfunduar më 9 qershor 1999 që i bie të jetë gjatë kohës së luftës.

Siç përsëritet në shumë aktvendime të Dhomës së Posaçme, është fakt i njohur se pas luftës menaxhmenti i NSH-ve kishte kaluar tek personat shqiptar. Ka qenë mjaft e vështirë, madje gati e pamundur, për ata të cilët kanë përkatësi etnike serbe që të punojnë në një ambient në mënyrë të qetë në NSH-të nën kontrollin e shqiptarëve fill pas luftës.

Para vitit 1999, punëtorët ishin, në masë të madhe, në gjendje që të paraqiteshin në punë pa ndërprerje. Megjithatë, pas konfliktit përçarës dhe ndërhyrjes ndërkombëtare në vitin 1999, njerëzit kryesisht nuk ishin të sigurt që të udhëtonin brenda Kosovës. Efekti është që punëtorët të cilët u takojnë grupeve minoritare, që jetojnë të ndarë nga shumica shqiptare ishin të cenuar nga e drejta që të paraqiteshin në punë pa ndihmesën pozitive të organit qeverisës.

Duke pasur parasysh kornizën ligjore dhe faktike më lartë, është kyçe të vërtetohet nëse rrethanat në Kosovë e kanë parandaluar ankuesin nga kthimi në punë prej qershorit të vitit 1999 e më tutje. Ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i studimeve dhe raporteve të cilat i referohen situatës aktuale në Kosovë, në veçanti pozitës së punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore pas konfliktit. Dhoma, pa mbajtur ndonjë mendim paragjykses lidhur me këtë çështje thjeshtë i referohet këtyre studimeve dhe raporteve sa i përket diskriminimit të pretenduar nga ankuesi.

Sipas Eide-s, shumica e punëtorëve të NSH-ve të cilat u takojnë komuniteteve të minoriteteve janë ndaluar të punojnë pasi që janë kërcënuar ose janë ekspozuar ndaj dhunës në periudhën prej viteve 1999-2000. Procesi i privatizimit të NSH-ve kishte nisur në vitin 2003, shumë kohë pas zhvendosjes fillestare të bashkësive joshqiptare dhe vetëm pak para dhunës së marsit të vitit 2004, pasojë e së cilës ishte një valë e re e zhvendosjeve. Eide më tej pohon se UNMIK-u nuk e kishte marrë parasysh situatën e IDP-ve/të kthyerve kur e miratoi Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/13, e ndryshuar me Rregulloren Nr. 45/2004, e cila thekson se “një punëtor është legjitim nëse ai punëtor është (...) i

regjistruar si punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore në kohën e privatizimit” (shih Kai Eide, “Një shqyrtim i përgjithshëm i situatës në Kosovë”, KB, S/2005/635, fq. 2-3.) Në një studim tjetër pohohet se UNMIK-u i ka përjashtuar shumicën e IDP-ve/të kthyerve, pasi që ata ishin të detyruar ta lëshonin Kosovën para vitit 2003 dhe nuk ishin më punëtor të NSH-ve në kohën e privatizimit (shih Kosova nën Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244 – UNIONI, Federata e IDP-ve Shoqatave – Parashtrësia tek Komisioni i KB-së për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, tetor 2008, shih E/C.12/UNK/1, para. 168).

Natyrisht se është e diskutueshme që të konsiderohet se ndonjë studim i tillë e pasqyron krejtësisht të vërtetën e plotë pa qenë i njëanshëm, megjithatë është një besim dhe dije e përgjithshme se personat me përkatësi etnike serbe nuk e kanë pasur lirinë të udhëtojnë brenda territorit të Kosovës pa intervenimin dhe përcjelljen nga stafi i KFOR-it pas luftës dhe për shkak të situatës *de facto* në Kosovë. Më tej është e pamundur të pritët nga punëtori me përkatësi etnike serbe për të kërkuar ndihmesën e forcave ndërkombëtare për ta siguruar udhëtimin e tij për vajtje ardhje në punë në bazë ditore dhe asnjë staf i tillë nuk ka mundur ta kryej një mbrojtje të tillë rregullisht për një periudhë të gjatë kohore.

Për më tepër, në Raportin e Komisionit të Evropës, i cili mund të konsiderohet si neutral, pranohet se ish punëtorët e NSH-ve të cilët u takojnë bashkësive joshqiptare vazhduan të pretendojnë në vitin 2007 se ata nuk ishin në gjendje që të merrnin pjesë dhe të përfitonin nga procesi i privatizimit për shkak të karakterit diskriminues të kornizës rregullative (shih, Komisioni Evropian, *Kosova (nën KROKB 1244) 2007 Raporti i Progresit*, Bruksel, 2007, fq. 26).

Në këto rrethana, Dhoma e konsideron se dështimi i ankuesit për t'u paraqitur në punë nga muaji qershor i vitit 1999 e më tej nuk ishte në asnjë mënyrë që t'i atribuohet dëshirës nga ana e tij që të mungojë vullnetarisht nga puna, por nga një mënyrë që rrjedh nga problemet e sigurisë në të cilat ai është gjendur. Edhe po që se ai do të mund të ishte në gjendje që ta përfaqësonte vetveten tek menaxhmenti i ri i NSH-së, do të kishte shumë pak gjasa se ai do të punësohej nga menaxhmenti i ri i përbërë kryesisht nga drejtorët me përkatësi etnike shqiptare që është edhe një fakt tjetër i njohur. Pra, po që se ai nuk do të diskriminohej, ai do të regjistrohej si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit dhe do të ishte në listën e pagave jo më pak se tri vite siç kërkohet nga Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13.

2. Sa i përket Ankuesit [REDAKTUAR]

(a) Parashtrësia e palëve

Në ankesën e tij, ankuesi pohoi se ai ishte punëtor i NSH-së gjatë privatizimit. Ai gjithashtu theksoi se ai ishte përjashtuar nga regjimi serb në vitin 1992 kundër së cilit ai e ka nisur një procedurë gjyqësore. Ai kërkoi që të ftohet në një seancë dëgjimore dhe të jep një deklaratë.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi ishte i përfaqësuar nga [REDAKTUAR] në pajtim me autorizimin e ofruar nga Gjykata. Përfaqësuesi i ankuesit konfirmoi se kontrata e ankuesit

ishite shkëputur në vitin 1992 duke u bazuar në diskriminim. Ai nënvizoi se klienti i tij e ka filluar një padi kundër shkëputjes së kontratës së tij pranë gjykatës kompetente kundër NSH-së. Ai theksoi se procedura gjyqësore zgjati derisa u mor një aktvendim në Gjykatën Komunale të Prizrenit ku Gjykata vendosi që ta pezullojë procedurën gjyqësore për shkak të privatizimit të ndërmarjes. Një kopje e atij aktvendimi ishte dërguar në Gjykatë e përcjellë me përkthimin e tij në gjuhën angleze.

I padituri AKP-ja pohoi se ankuesi punoi deri në vitin 1992 kur ishte ndërprerë punësimi i tij. AKP-ja më tej pohoi se nuk ka prova materiale lidhur me vazhdimin e punësimit të tij pas vitit 1992. AKP-ja nënvizoi që në kohën e privatizimit ankuesi nuk ishte në listën e pagave të NSH-së edhe pse librezë e tij e punës është ende e hapur. Megjithatë, ky pretendim ishte kontestuar nga përfaqësuesi i ankuesit duke theksuar se librezë e punës ishte mbyllur në vitin 1992.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

Paditësi e bashkëngjiti një kopje të librezës së tij të punës sipas së cilës ai ka punuar për NSH-në nga 15 qershor i vitit 1976 e deri më 26 qershor të vitit 1992. Librezë e punës ishte mbyllur pranë NSH-së [REDAKTUAR] më 26 qershor 1992.

Ankuesi e parashtrori ankesën e tij të mbështetur me dokumentacionin përkatës dhe pretendimet për diskriminim. Ishite vërtetuar nëpërmjet librezës së punës origjinale dhe deklaratës së përfaqësuesit të ankuesit gjatë seancës dëgjimore se ankuesi nuk ishte punëtor i regjistruar i NSH-së në kohën e privatizimit. Sidoqoftë, ankuesi pohoi për diskriminimin i cili kishte ndodhur gjatë viteve të 1990ta që rezultoi me përjashtimin e tij nga puna kundër së cilit ai ka nisur një procedurë gjyqësore. Fakti që librezë e punës ishte mbyllur pranë NSH-së [REDAKTUAR] në vitin 1992 ishte vërtetuar nga Gjyqtari Raportues i cili ka drejtuar seancën e administrimit të provave me anë të kontrollimit të librezës së punës origjinale.

Ajo çfarë është më e rëndësishme është se Autoriteti i Menaxhmentit të Përkohshëm i NSH-së [REDAKTUAR] e shkëputi punësimin e ankuesit më 26 qershor të vitit 1992 në pajtim me Nenin 8 paragrafin 1/3 dhe 1/4 i Ligjit të Punësimit në Rrethana të Jashtëzakonshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 40/90) kundër së cilit ankuesi ka nisur një padi pranë Gjykatës Komunale të Prizrenit. Në padinë e parashtruar pranë Gjykatës Komunale të Prizrenit, ankuesi ka kërkuar që të kthehet në vendin e tij të punës. Procedura gjyqësore përfundoi me një aktvendim të Gjykatës së cekur C nr. 88/93, të datës 26.06.2008, duke pezulluar procedurën gjyqësore në pajtim me Nenin 212 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore për shkak të faktit se NSH-ja ishte privatizuar dhe prandaj personi juridik si palë në procedurë pranë Gjykatës ka pushuar së ekzistuari.

Përveç librezës së punës, ankuesi parashtrori në Dhomë aktvendimin mbi ndërprerjen e punësimit të tij, kundërshtim të cilin ai e ka parashtruar tek Autoriteti i Përkohshëm i Ndërmarrjes së Duhanit [REDAKTUAR], aktvendimi i organit në fjalë për kundërshtimin e tij dhe padinë të cilën e ai e ka parashtruar pranë Gjykatës Komunale kundër aktvendimit të

Autoritetit të Përkohshëm të Ndërmarrjes së Duhanit [REDACTED] duke e refuzuar kundërshtimin e tij, në pajtim me këshillën juridike të paraqitur në këtë të fundit. Aktvendimi i Autoritetit të Përkohshëm lidhur me refuzimin e kundërshtimin e ankuesit e mban datën 9 korrik 1992. Në padinë e ushtruar pranë Gjykatës Komunale të Prizrenit, data e njoftimit të aktvendimit në fjalë ishte përmendur të jetë 17 korrik 1992. Padia e mban datën 21 korrik 1992. Natyrisht se nuk mund të vërtetohet nga ky dokument se kur ishte parashtruar padia në Gjykatë. Edhe pse aktvendimi i Gjykatës Komunale, C. nr. 88/93, i datës 26.06.2008, nuk e tregon datën e parashtrimit të padisë, Dhoma e Posaçme e sheh se padia nuk ishte refuzuar si e papranueshme nga Gjykata Komunale për arsyet se ishte jashtë afatit kohor dhe se procedura gjyqësore zgjati derisa NSH-ja ishte privatizuar. Ishte pas kësaj që Gjykata Komunale e Prizrenit vendosi ta pezullojë procedurën gjyqësore për shkak të privatizimit të NSH-së. Rrjedhimisht, në kohën e privatizimit, ligjshmëria e aktvendimit të Autoritetit të Përkohshëm të NSH-së [REDACTED] lidhur me përfundimin e punësimit të ankuesit ishte ende në pikëpyetje. Gjykata nuk është përgjigjur në pyetjen nëse hedhja poshtë ishte në përputhje me ligjin ose jo për një periudhë të gjatë kohore që në vetvete do të mund të kishte një vonesë të paarsyeshme në zhvillimin e procedurës gjyqësore. Dhoma e Posaçme sheh se, pas privatizimit të ndërmarrjes, Gjykata tek e cila është parashtruar padia kundër aktvendimit lidhur me përfundimin e punësimit të ankuesit vendosi për pezullim. Ky aktvendim megjithatë nuk e ka zgjidhur çështjen kryesore në procedurën gjyqësore e cila është lidhur me atë nëse hedhja poshtë ka qenë e jashtëligjshme a po jo. Pra, hedhja poshtë e ankesës kurrë nuk është miratuar nga ana e Gjykatës. Statusi i punëtorit mbetet i pazgjidhur. Prandaj, Dhoma e konsideron se vonesa në procedurën gjyqësore dhe fakti se NSH-ja ishte privatizuar derisa procedura gjyqësore ishte ende në pritje pas kaq shumë viteve nuk mund ta përjashtojë mundësinë që ankuesi të kthehet në vendin e tij të punës në ndërmarrje dhe të jetë ai i cili i bartë pasojat e shtyrjeve në udhëheqjen e privatizimit. Ankuesi nuk duhet të jetë ai i cili i bartë pasojat e shtyrjeve në udhëheqjen e procedurës gjyqësore pavarësisht nëse ajo është e arsyeshme apo e paarsyeshme. Mund të thuhet sigurisht se nuk u takon as punëtorëve të tjerë të NSH-së që t'i bartin pasojat e vonesës në procedurën gjyqësore të cilët tashmë e kanë përmbushur kërkesën e ligjit në mënyrë që të konsiderohen me të drejta të plota. Përfshirja e cilitdo punëtor tjetër në listën e punëtorëve me të drejta të plota do të rezultonte në zvogëlimin e shumës së pjesës e cila do të merrej nga ata të cilët tashmë janë në listë. Sidoqoftë, ajo çfarë duhet të merret parasysh këtu është se ankuesi ka mundur të regjistrohet si punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit dhe ka mundur të jetë në listën e pagave të NSH-së për jo më pak se tre vjet nëse Gjykata kishte vendosur për zgjidhjen e kërkuar nga ai para se të privatizohej ndërmarrja.

Për më tepër, në ankesën e tij të parashtruar pranë Dhomës së Posaçme, ankuesi në mënyrë eksplicite pohoi se ai ishte diskriminuar në vitin 1992 kur qeveria serbe i kërkoi atij ta nënshkruante një deklaratë të veçantë për pranimin ish qeverinë serbe në Kosovë të cilën ai nuk e ka njohur. Siç u thekua më lartë, ankuesi së pari e kundërshtoi aktvendimin mbi shkëputjen e marrëdhënies së tij të punës me NSH-në para Autoritetit të Përkohshëm të NSH-së dhe më pas ai e kundërshtoi ligjshmërinë e atyre aktvendimeve para Gjykatës kompetente dhe kërkoi që ai të kthehet në vendin e tij të punës. Edhe pse ankuesi nuk i

ishite referuar në mënyrë eksplicite asnjë lloj diskriminimi në padinë e tij të ushtruar në Gjykatën Komunale, mund të shihet nga padia se ai ankohej ndaj veprimeve arbitrare të Autoritetit Menaxhues të Përkohshëm. Sigurisht se nuk mund të pritet se në ato vite në ato rrethana kur të gjithë gjyqtarët me përkatësi shqiptare ishin përjashtuar nga profesioni i tyre të pretendojë diskriminimin në mënyrë eksplicite (për përjashtimin e gjyqtarëve, shih Raportin lidhur me situatën e të Drejtave të Njeriut në territorin e ish Jugosllavisë të paraqitur nga Z. Tadeusz Mazowiecki, Raportues Special i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me Rezolutën e Komisionit 1992/s-1/1 në gushtin e vitit 1992, A/48/92-S25341). Ankuesi të paktën aty pohoi se autoriteti i përkohshëm ka vepruar në mënyrë të paligjshme. Në kundërshtimin e tij të parashtruar tek Autoriteti i Përkohshëm, ai madje e kundërshtoi aktvendimin për përfundimin e kontratës me fjalët në vijim *"rezulton se autoriteti menaxhues i ka kuptuar masat e përkohshme si një hyrje në mbretërimin e terrorit në mes të punëtorëve të cilët thjeshtë nuk mund të shkojnë as në tualet pa miratimin specifik nga autoriteti menaxhues"*. Dhoma e konsideron se Autoriteti i Përkohshëm i përmendur këtu i referohet menaxhmentit të NSH-së gjatë viteve 1989-1999. Përveç kësaj, Trupi Gjyqësor i Dhomës së Posaçme e shpjegon kuptimin e masave të përkohshme të përmendura në atë kundërshtim, që e mbajnë datën e 1 korrikut të vitit 1992, të parashtruara tek Autoriteti i Përkohshëm i NSH-së [REDAKTUAR] si masat e përkohshme të miratuara nga parlamenti serb të cilat pretendohen të jenë, në disa studime, imponim i një regjimi shtypës dhe diskriminues që rezultoi me diskriminimin e hapur në baza kombëtare, përjashtimi i të gjithë udhëheqësve shqiptar nga pozitat udhëheqëse në ndërmarrjet e tyre, heqja e Këshillave të Punëtorëve dhe përjashtimi i rreth 70% të punëtorëve shqiptar. (Shih 'Raportin Hulumtues, 20 qershor 2002, Konferenca Ndërkombëtare për Privatizimin e NSH-ve dhe Reforma e Shërbimeve në Kosovë', 27-29 qershor, 2002, Prishtinë, fq. 25-26.) Dihet se në ato vite menaxhmenti i NSH-ve tentoi të tregonte shkaqe të ndryshme për ta arsytuar shkarkimin e punëtorëve shqiptarë por jo përkatësinë etnike. Në rastin në fjalë, menaxhmenti i përkohshëm i NSH-së në atë kohë iu referua disa sjelljeve të punëtorit si marrja e pushimit mjekësor pa njoftim paraprak, largimi nga vendi i punës me paramendim.

Burime të ndryshme pranojnë se shumë shqiptar ishin përjashtuar nga vendet e tyre të punës në kuadër të regjimit i cili u fut me dhunë në Kosovë nga marsi i vitit 1989 e më tej, deri në verën e vitit 1999, periudha e quajtur si era e Millosheviqit (shih Raportin lidhur me situatën e të Drejtave të Njeriut në territorin e ish Jugosllavisë të paraqitura nga Z. Tadeusz Mazowiecki, Raportues Special i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me Rezolutën e Komisionit 1992/s-1/1 në gushtin e vitit 1992, A/48/92-S25341, para. 153-171, 26 shkurt 1993; Florian Bieber dhe Zidas Daskolovski Kuptimi i Luftës në Kosovë, Botimet Florian Bieber dhe Zidas Daskolovski, 2003, Britania e Madhe MPG Books Ltd, faqe 64; të Drejtat e Njeriut në Jugosllavi 1998 (Beograd, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Beograd, 1999; Shkelja e të Drejtave të Njeriut në territorin e ish Jugosllavisë 1991-1995, Beograd HLC, 1997).

Qeverisja e vendit gjatë viteve 1989-1999 dhe veprimtaritë rreth grupit dominues të asaj kohe kanë pasur një shtrirje aq të gjerë në psikikën vetëdijën e kosovarëve saqë është bërë fakt i njohur, sepse është zhvilluar në një prizëm të faktit të padiskutueshëm përtej

pyetjes dhe kundërshtimit.

3. Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Duhet të nënvizohet se ankuesi i parë i përkatësisë etnike serbe pretendon diskriminim për shkak të faktit se ai ishte i larguar nga puna gjatë luftës e cila u zhvillua gjatë vitit 1999 dhe ankuesi i dytë me përkatësi etnike shqiptare pretendon se e njëjta ka ndodhur gjatë kohës së Millosheviqit.

Duke pasur parasysh kohën kur ankuesit janë larguar nga puna ose që është dashur ta braktisin punën në NSH; dhe duke e pasur parasysh përkatësinë etnike të tyre; duke pasur parasysh faktin se punëtorët me përkatësi etnike shqiptare iu nënshtruan diskriminimit gjatë viteve 1989-1999 dhe e njëjta vlen për punëtorët me përkatësi etnike serbe pas vitit 1999 për shkak të kushteve të sigurisë që është fakt i njohur, Trupi Gjykses është i mendimit se këta ankues duhet konsideruar se i kanë paraqitur faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejt apo të tërthortë dhe se ata do të ishin me të drejta të plota në qoftë se ata nuk do t'i nënshtrroheshin diskriminimit. Trupi Gjykses konsideron se diskriminimi kundër punëtorëve në ndërmarrjet shoqërore që ishte bërë gjatë periudhës 1989-1999 është një fakt i njohur i cili nuk ka nevojë që të vërtetohet me dëshmi të tjera nga ankuesi në rastin në fjalë. Në anën tjetër, diskriminimi i punëtorëve me përkatësi etnike serbe që rrjedh nga kushtet e sigurisë në Kosovë pas vitit 1999 është një fakt tjetër i njohur.

Faktet e njohura janë mjetet me të cilat gjykata i merr faktet përkatëse si të vërtetuara pa dëgjimin e dëshmimeve. Kur fakti merret si i njohur nga gjyqtari, nuk kërkohet vërtetimi i tij, por shpesh është e nevojshme të tregohet se është i njohur, pasi që nuk pritet nga gjyqtari që ta dijë secilin fakt të njohur, dhe në përgjithësi personi me autoritet, duke mbajtur atë që është e njohur që të jetë e sigurt dhe e vërtetuar, nuk kërkon informata të mëtejme dhe prandaj që të dyja munden dhe duhet të përmbahen nga çdo hetim, dëshmi ose formalitet gjyqësor që në të kundërtën do të ishin të nevojshme. Lidhur me këto hetime dhe formalitete të cilat kanë si qëllim sqarimin e mendimit të gjyqtarit, janë të padobishme kur fakti është i njohur. Zakonisht kuptimi i faktit të njohur është i barabartë me publikun, manifestimin e qartë dhe të ditur; të gjitha këto terme kanë diçka të përbashkët, ato tregojnë se një gjë, larg nga të qenit e fshehtë, mund të dihet shumë lehtë nga shumica. Njohja, përveç kësaj ideje të përgjithshme, përfshinë idenë e dëshmisë së padiskutueshme, pra çka është e njohur mbahet si e vërtetuar dhe shërben si bazë për përfundimet dhe veprimet e atyre të autorizuarve, në veçanti gjyqtarëve. Çfarëdo që tregohet me lehtësi dhe njihet nga një numër i mjaftueshëm i personave të jetë i lirë nga dyshimi i arsyeshëm është i njohur në të vërtetë.

Faktet e njohura (p.sh. çështjet e njohurive të përgjithshme) mund të vërehen juridikisht pa hetim; disa fakte të tjera (p.sh. çështjet të cilat lehtë mund të kontrollohen në punën standarde të referimit dhe janë me arsye të padiskutueshme) mund të vërehen pas

hetimit. Kur është marrë njoftimi juridik, nuk lejohet dëshmia në kundërshtim ([http://law.jrank.org/pages/20942/judicial-notice-\(judicial-cognizance\).html](http://law.jrank.org/pages/20942/judicial-notice-(judicial-cognizance).html)).

Vetëm nga pikëpamja thjeshtë e Ligjit Kundër Diskriminimit; që të dy ankuesit kanë paraqitur dëshmi për ta vërtetuar marrëdhënien e tyre të punës me NSH-në [REDACTED] dhe kanë paraqitur dokumentet e nevojshme për të vërtetuar pranë Dhomës së Posaçme faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Më pas, sipas Ligjit Kundër Diskriminimit 2004/3, i takon të paditurit të vërtetojë se nuk ka pasur shkelje të parimit për trajtim të barabartë, megjithatë i padituri nuk ka paraqitur asnjë dëshmi se nuk ka pasur shkelje të parimit për trajtim të barabartë në kuptim të Nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit.

Në bazë të arsyeve të cekura më lartë Dhoma gjen se:

Ankuesit duhet të pranohen për përfshirjen e tyre në listën e punëtorëve me të drejta legjitime pasi që ata do të ishin futur në regjistrin e punëtorëve të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit në vitin 2006 në qoftë se ata nuk do të diskriminoheshin.

Duke u bazuar në konsideratat e mësipërme dhe në pajtim me Nenin 4.1 (e) dhe 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe Nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, dhe Nenin 67 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, dhe Nenin 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit Nr. 2004/3, Dhoma vendos si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

III. Shpenzimet

I padituri është i obliguar t'i pranojë shpenzimet procedurale për pjesëmarrjen në seancat dëgjimore të avokatëve të ankuesve në shumën prej 101 eurove për secilin, pra shuma e përgjithshme prej 202 eurove (Tarifa e Avokatit e 11 qershorit 2005, e lëshuar në bazë të Ligjit mbi Avokaturën, Gazeta Zyrtare e Kosovës 48/79).

IV. Këshilla Juridike

Kundër këtij Aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek kolegji i apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Aktgjykimit.

Antoinette Lepeltier - Durel, Gjyqtare,
EULEX

Esmat Erterzi,
Gjyqtare, EULEX

Ilmi Bajrami, Gjyqtar

Tobias Lapke, Regjistruer
